

**VENDIM**  
**Nr. 867, datë 14.12.2016**

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 23, DATË 20.1.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR VITIN 2016 NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr.147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 23, datë 20.1.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 1, të vendimit, numri i punonjësve dhe praktikantëve me kontratë të përkohshme, ndryshohet dhe bëhet “...2410 veta ...”.
  2. Pas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2, të përmendura në pikën 1, të vendimit, shtohet lidhja nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
  3. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë pas hyrjes në fuqi të tij dhe përballohen nga buxheti i miratuar për institucionet e përmendura në këtë lidhje.
  4. Ngarkohen institucionet e përmendura në këtë lidhje për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

Lidhja nr. 3

| <b>Emri i institucionit</b>                                          | <b>Numri i punonjësve</b> | <b>Emërtesa, kategoria</b> | <b>Kohëzgjatja ditore</b> | <b>Periudha kohore</b> |
|----------------------------------------------------------------------|---------------------------|----------------------------|---------------------------|------------------------|
| Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë                            | 30                        | Specialist IV-b            | 8 orë                     | dhjetor                |
| Ministria e Punëve të Brendshme                                      | 5                         | Specialist IV-b            | 8 orë                     | dhjetor                |
| Ministria e Energjisë dhe Industrisë                                 | 25                        | Specialist IV-b            | 8 orë                     | dhjetor                |
| Ministria e Financave                                                | 22                        | Specialist IV-b            | 8 orë                     | dhjetor                |
| Ministria e Arsimit dhe Sportit                                      | 8                         | Specialist IV-b            | 8 orë                     | dhjetor                |
| Ministria e Kulturës                                                 | 6                         | Specialist IV-b            | 8 orë                     | dhjetor                |
| Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes | 9                         | Specialist IV-b            | 8 orë                     | dhjetor                |
| Ministria e Mbrojtjes                                                | 5                         | Specialist IV-b            | 8 orë                     | dhjetor                |
| Ministria e Zhvillimit Urban                                         | 10                        | Specialist IV-b            | 8 orë                     | dhjetor                |
| Ministria e Mjedisit                                                 | 8                         | Specialist IV-b            | 8 orë                     | dhjetor                |
| Kryeministria                                                        | 29                        | Specialist IV-b            | 8 orë                     | dhjetor                |
| Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës                          | 9                         | Specialist IV-b            | 8 orë                     | dhjetor                |
| Ministria e Shëndetësisë                                             | 12                        | Specialist IV-b            | 8 orë                     | dhjetor                |
| Ministria e Punëve të Jashtme                                        | 10                        | Specialist IV-b            | 8 orë                     | dhjetor                |
| Ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin                   | 2                         | Specialist IV-b            | 8 orë                     | dhjetor                |
| Ministria e Drejtësisë                                               | 10                        | Specialist IV-b            | 8 orë                     | dhjetor                |
| <b>Total</b>                                                         | <b>200</b>                |                            |                           |                        |